



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
GJIMNAZI “PERIKLI IKONOMI” FIER

PLANI VJETOR
PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025

PROCEDURA E HARTIMIT TË PLANIT

Plani vjetor i gjimnazit “Perikli Ikonomi” Fier për vitin shkollor 2024-2025 hartohet mbështetur në:

- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nenet 51-53;
- Udhëzimin e përbashkët nr. 13, datë 10.7.2024 “Për vitin shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar”;
- Planin afatmesëm të shkollës 2022-2026.

Hapi i parë për hartimin e planit është analiza e bërë rezultateve në përfundim të vitit shkollor në qershor 2024, me në fokus analizën e rezultateve të sesionit të parë të provimeve të Maturës Shtetërore dhe përpunimi i të dhënave për plotësimin e Kartës së Performancës së shkollës 2023-2024.

Puna e kryer gjatë vitit në gjimnazin tonë për zbatimin e projektit “Qëndro në shkollë”, një projekt i shtrirë në shumë shkolla në vend me mbështetjen e qeverisë italiane dhe UNICEF Shqipëri, vlerësohet mjaft e suksesshme, duke shërbyer si pikë referimi për orientimin e hartuesve të planit vjetor.

Drejtorja e shkollës në përfundim të vitit shkollor 2023-2024 ka hartuar raportin vjetor, i cili është një dokument tjetër i marrë në konsideratë për planifikimin e objektivave të ardhshëm.

Në datën 26.8.2024 në mbledhjen e këshillit të mësuesve u ngrit grupi i punës për hartimin e planit për vitin shkollor 2024-2025, i kryesuar nga drejtorja e shkollës

Megjithëse plani u hartua brenda muajit gusht, zgjatja e afatit për regjistrimin e nxënësve në klasën X dhe situata me numrin e nxënësve në këtë klasë (afër numrit të kërkuar për hapjen e një paraleli tjetër), janë shkaku që plani përfundoi në fund të javës së parë të muajit shtator.

Në datën 6.9.2024 plani i hartuar iu paraqit kryetares së bordit të shkollës dhe u miratua.

Plani vjetor i shkollës i paraqitet për miratim ZVAP Fier, i parashikuar të zbatohet prej ditës së parë të vitit të ri shkollor, më 9.9.2024.

ANALIZA E GJENDJES

1. Ndjekja e IA-së (përqindja e braktisjes së shkollës, përqindja e mungesave vjetore e të gjithë nxënësve kundrejt të gjitha orëve mësimore).

Gjatë vitit shkollor 2023-2024 u larguan nga kontingjenti 22 nxënës nga 447 të regjistruar në shtator 2023, ose 4,9%. Një vit më parë ky tregues ishte 8%, ndërsa para dy vitesh 12%. Në shkolla të tjera jashtë qytetit ose të larguar jashtë vendit në fund të vitit shkollor 2023-2024 numërohen 13 nxënës, afërsisht 60% e të gjitha largimeve. Nuk ka nxënës të larguar drejt gjimnazeve të tjera brenda qytetit (një vit më parë kjo kategori ishte 2% e kontingjentit të shtatorit 2022), ndërsa 2 nxënës të transferuar në arsimin profesional u orientuan për këtë lëvizje prej vetë drejtorisë së gjimnazit. 7 nxënës u përjashtuan për arsye mungesash, ndërsa 3 të tjerë janë larguar pa dhënë arsye; në total 10 nxënës (2,2% e kontingjentit të shtatorit 2023, përkundrejt 4% një vit më parë) i konsiderojmë largime nga sistemi arsimor për arsye që mund të shmangen pjesërisht me ndërhyrjen e shkollës. Megjithëse në total tendenca e largimeve është në rënie këtë vit, niveli i përjashtimeve për arsye mungesash është rritur nga 0,6% në 1,6%. Si rezultat edhe i zbatimit të projektit “Qëndro”, përfundimisht me këtë nivel më të ulët të largimeve nga shkolla, u realizua edhe objektivi i parë i planit vjetor 2023-2024.

Gjatë vitit shkollor 2023-2024 nxënësit kanë munguar mesatarisht në 1,39% të orëve mësimore nga 1,58% një vit më parë.

Anë e fortë:

Zbatimi i masave disiplinore për nxënësit që mungojnë pa arsye, ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë për evidentimin e mungesave dhe informimi i shpejtë i prindërve për mungesat e nxënësve kanë efekt në ndërgjegjësimin e nxënësve në frekuentimin e rregullt të shkollës.

Anë të dobëta:

Tendencë largimi i nxënësve për arsye të tjera që nuk lidhen me shkollën. Kontaktimi i prindërve për mungesat e nxënësve nuk është i menjëhershëm, informimi i mësuesve kujdestarë vijon të jetë i ngadaltë.

2. Aspekti social

Gjimnazi ynë vijon të jetë i hapur për shtresat e marginalizuara, në kushte të pafavorshme sociale dhe për nxënësit nga kultura të ndryshme. Në hartën sociale 2023-2024 figurojnë 15 nxënës (3% e kontingjentit, 1% më e ulët se një vit më parë) nga familje në skemën e ndihmës ekonomike. 8 nxënës ishin jetimë me një prind. 17 nxënës ose 4% e kontingjentit vinin nga familje me prindër të divorcuar (1% më e lartë se një vit

më parë). Pavarësisht riskut, nuk u evidentuan problematikat eventuale prej nxënësve të këtyre kategorive, falë edhe përkujdesjes nga ana e mësuesve dhe punës efektive prej oficerës së sigurisë dhe psikologes së shkollës.

Rreth 48% e prindërve të nxënësve ishin me nivel të ulët arsimor (arsim bazë, një rënie e lehtë krahasuar me një vit më parë), 45% e tyre ishin me arsim të mesëm (5% më shumë se një vit më parë), ndërsa me arsim të lartë ishin 7% e prindërve. Ky tregues lidhet drejtpërdrejt me indiferencën e një pjese të prindërve ndaj aktivitetit të shkollës, pjesëmarrjes në vendimmarrjet e organizmave të saj dhe mosinteresimin mbi frekuentimin e rregullt të fëmijëve të tyre. Në fillim të vitit të kaluar shkollor, në hartën sociale të shkollës u evidentuan 61 nxënës (14% e kontingjentit, përkundër 6% një vit më parë) si nxënës që shfaqnin talent në fusha të caktuara, ndërsa nxënës me vështirësi në të nxënë nuk janë evidentuar nga shërbimi psikosocial. Në gjimnazin tonë u regjistruan dy nxënës nga komuniteti rom; një nxënës u transferua në shkollën profesionale gjatë muajit tetor 2023, ndërsa nxënësja rome përfundoi me sukses klasën XI dhe këtë vit është maturante. Në mënyrë të vazhdueshme janë bërë përpjekje për të afruar edhe nxënës të tjerë nga ky komunitet, prej shkollave 9-vjeçare të afërta, por nuk ka pasur rezultat domethënës.

Anë e fortë:

Nuk ka numër të lartë të kategorive problematike të nxënësve.

Anë e dobët:

Konstatohet indiferencë nga prindërit e nxënësve që mungojnë në shkollë dhe mungesë bashkëpunimi nga komuniteti për mbështetjen e tyre.

3. Rezultatet e nxënësve

Në përfundim të vitit mësimor 2023-2024, rezulton se nota mesatare e nxënësve të të gjithë shkollës për vitin shkollor është 7,78, ndërsa një vit më parë, në qershor 2023, ishte llogaritur në 7,65, (në qershor 2022 u raportua 7,5 dhe në qershor 2021 ishte 7,42). Tendenca në rritje e nivelit është e dukshme dhe mbi këtë bazë mbështetet edhe njëri prej objektivave për vitin e ri shkollor. 110 maturantë nga 132 kalues në provimet e sesionit të parë të MSH 2024 arritën mesataren e përgjithshme (të tri viteve dhe të provimeve) për pranim në programet e studimeve në universitetet brenda vendit.

Kalueshmëria e nxënësve të shkollës për këtë vit shkollor (statistikat e qershorit 2024) ishte 93,6%, ndërsa në qershor 2023 ishte 94,4%. Niveli i synuar në planin vjetor të vitit shkollor prej 95% nuk u arrit të realizohej për shkak të mbetjes në një ose dy lëndë të 27 nxënësve, 6 prej të cilëve maturantë .

Pas provimeve të klasës në sesionin e dytë kaluan në klasën pasardhëse edhe 21 nxënës të klasave X dhe XI, duke rritur kalueshmërinë e vitit shkollor në nivelin 100% nga 99,3% një vit më parë.

Diferenca mes notave vjetore dhe atyre të provimeve të detyruara në sesionin e parë të MSH 2024 llogaritet në shifrën 0,40, ndërsa një vit më parë ishte 0,53. Por, në këto tri provime përqindja e nxënësve që rezultuan me diferencën (në vlerë absolute) më të madhe se 1 notë ishte 47,9% nga 21,2% një vit më parë.

Anë e fortë:

Nota mesatare e nxënësve është më të lartë krahasuar me vitet e kaluara, ndërkohë diferenca midis vlerësimit të brendshëm (nota vjetore) dhe atij të jashtëm (nota e provimeve) është më e ulët se një vit më parë, duke konsoliduar nivelin cilësor si objektiv të planit afatmesëm.

Anë e dobët:

Kalueshmëria në fund të vitit mësimor, për shkak të mungesave në lëndë të caktuara, është më e ulët se një vit më parë.

4. Treguesit për të cilët shkolla ka arritjen më të mirë dhe më të ulët në renditje për institucionet arsimore të suksesshme në nivel ZVA-je.

Ende nuk është publikuar renditja e institucioneve arsimore në shkallë ZVA-je, në bazë të treguesve të kartës së performancës.

5. Etika dhe sjellja

Gjatë vitit shkollor 2023-2024 nuk ka pasur ankesa për të cilat është mbledhur komisioni i etikës dhe sjelljes në shkollë.

Anë e fortë:

Shkolla ka një oficerë sigurie aktive gjatë kohës së funksionimit të shkollës, e cila ka bashkëpunim të plotë me mësuesit dhe strukturat e policisë.

Anë e dobët:

Nuk evidentohet problematikë.

6. Arritjet në provimet kombëtare dhe në testimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në sesionin e parë në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore 2024 u arrit një nivel kalueshmërie 99,49%, duke u përmirësuar me 0,24 nota krahasuar me vlerën 99,25% në kartën e performancës së një viti më parë. Në përfundim të sesionit të parë të MSH

kalueshmëria ishte 95%, ndërsa rezultatet e sesionit të dytë nuk janë shpallur ende nga QSHA.

Në sesionin e parë në provimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë kaluan 100% e nxënësve (nga 98,5% një vit më parë), me notë mesatare 7,34 (vjet ishte 7,6). Në provimin e matematikës kalueshmëria në qershor ishte 100% nga 99,3% një vit më parë, me notë mesatare 7,29 (shumë më mirë se mesatarja 6,4 një vit më parë). Ndërsa në provimin e gjuhës angleze në qershor kaluan mbi 98,5% e maturantëve (nga 100% një vit më parë, një nxënës u vlerësua me notën 4 dhe një nxënëseje nuk iu njoh rezultati pasi kishte shkruar emrin në test). Nota mesatare në këtë provim ishte 7,41 nga 7,6 para një viti. Nota mesatare e tri provimeve të detyruara në sesionin e parë të MSH 2023 ishte 7,35, me një rritje të lehtë krahasuar me qershorin 2023 (7,11) duke u përmirësuar me 0,24 nota. Në provimin me zgjedhje kalueshmëria është në nivelin 100% nga 96,2% një vit më parë 7,76 duke u përmirësuar ndjeshëm nga vlera 6,8 e një viti më parë, evidentuar edhe si pika më e dobët e rezultateve të nxënësve të vitit të kaluar në MSH. Kjo dëshmon përmirësimin e arritur mbështetur në analizën e vitit të mëparshëm.

Gjatë vitit shkollor 2023-2024 nxënësit e gjimnazit tonë u përgatitën për testimin ndërkombëtar PISA FT, por ky testim nuk u zhvillua në shkollën tonë nga organizatorët. Nuk janë zhvilluar teste kombëtare ose ndërkombëtare me nxënësit e shkollës sonë.

Anë e fortë:

Ka përmirësim të cilësisë së shkollës në treguesin e kalueshmërisë dhe të notës mesatare vjetore në tërësi dhe në provimin me zgjedhje.

Anë e dobët:

Evidentohet mangësi në përgatitjen e maturantëve për plotësimin e testit.

7. Mësuesit: përqindja e orëve mësimore të munguara nga mësuesit kundrejt të gjitha orëve mësimore, numri i krediteve të punonjësve arsimorë.

Ky tregues nuk përfshihet më në treguesin e performancës së shkollës. Nuk ka pasur mungesa të mësuesve brenda një dite pune, ndërsa në 181 ditë mësimore të vitit shkollor 2023-2024 (shumëzuar për 32 mësues llogariten në 5792 ditë pune) ka pasur 112 ditë mungesa, 1,93% e totalit ose 3,5 ditë të munguara për çdo mësues. Mësuesit kryesisht kanë munguar për arsye shëndetësore, vërtetuar me raport mjekësor. Nuk ka pasur mungesa të pajustificuara nga ana e mësuesve, megjithëse 14 ditë pune në total kanë munguar për arsye të tjera, duke vënë në dijeni drejtorinë e shkollës. Një mësuese, për arsye shëndetësore, ka munguar gjatë gjithë vitit dhe vazhdon të jetë me raport nga KMCAP, është zëvendësuar dhe nuk llogaritet më sipër.

Në vitin shkollor 2023-2024 një mësuese iu nënshtroi testit të kualifikimit profesional me rezultatin “Shumë mirë”. Gjatë vitit shkollor nga mësuesit e shkollës janë përfituar 32 kredite, ose 1 kredit për mësues, por disa prej mësuesve nuk kanë .

Anë e fortë:

Nivel i lartë i disiplinës në punë dhe angazhimit të personelit.

Anë e dobët:

Jo të gjithë mësuesit vijnë kualifikimin profesional nëpërmjet trajnimeve.

8. Pjesëmarrja në projekte me OJF, në olimpiada, konkurse, gara.

Duke përmbushur me sukses njërin prej objektivave të planit vjetor 2023-2024, nxënësit e shkollës sonë morën pjesë denjësisht në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Qendra e Kulturës e Bashkisë Fier, të organizuara në bashkëpunim me ZVA Fier, dhe në fazën e dytë të olimpiadave kombëtare në lëndët e biologjisë, informatikës, letërsisë dhe historisë.

- *Krosi i vjeshtës 2023. Vendi I, vajza*
- *Krosi i vjeshtës 2023. Vendi I, djem*
- *Krosi i vjeshtës 2023. Vendi II, djem*
- *Krosi i vjeshtës 2023. Vendi III, vajza*
- *Kampionati i basketbollit për vajza. Vendi IV*
- *Kampionati i basketbollit për djem. Vendi IV*
- *Kampionati i shahut për djem. Vendi I*
- *Kampionati i shahut për vajza. Vendi II*
- *Kampionati i futbollit për djem. Vendi I*
- *Kampionati i volejbollit për djem. Vendi III*
- *Kampionati i volejbollit për vajza. Vendi IV*
- *Festivali Teatror për të Rinj 2024. Shfaqja më e mirë*
- *Olimpiadat Kombëtare 2023-2024, faza II. 2 vende III, informatikë*
- *Olimpiadat Kombëtare 2023-2024, faza II. Vendi III, histori*
- *Olimpiadat Kombëtare 2023-2024, faza II. 2 vende III, biologji*
- *Olimpiadat Kombëtare 2023-2024, faza II. Vendi II, letërsi*
- *Olimpiadat Kombëtare 2023-2024, faza II. 4 vende III, letërsi*

Ky tregues është përmirësuar me 4 çmime të vlerësuara, krahasuar me vlerën 18 vende në kartën e performancës së një viti më parë.

Gjatë vitit shkollor 2023-2024 është bashkëpunuar me KOKSH-in për projektin “Ekipet sportive në shkollë” me krijimin dhe aktivizimin e dy ekipeve të basketbollit.

Nxënësit e shkollës sonë morën pjesë në festivalin e teatrit për të rinjtë në maj 2024 të organizuar nga ZVA, me një pjesë teatrore duke fituar vendin e parë për interpretimin. Është bashkëpunuar edhe me Akademinë e Filmit dhe Multimedias “Marubi”.

Anë e fortë:

Nxënësit e shkollës sonë po prezantojnë talentin e tyre në disa fusha, në shkencat e natyrës, shkencat humane, në sport dhe aftësi për jetën.

Anë e dobët:

Ende nuk është konsoliduar puna e diferencuar me talentet nëpërmjet klubeve shkencore.

9. Qëndrimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga IA-ja.

Për vlerësimin e shkollave, ZVA Fier ka zhvilluar në muajin maj pyetësorët e kartës së performancës me nxënësit, prindër dhe mësues të shkollës.

Perceptimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të gjimnazit tonë shprehet si më poshtë:

99,7% e nxënësve shprehen se “janë plotësisht dakord” (97,4%) ose “dakord” (mbi cilësinë e shkollës (nga 87,4% në pyetësorin e vitit të kaluar). Edhe pak nxënës që janë shprehur në mënyrë të rezervuar ose negativisht, kanë pasur vërejtje mbi kushtet në shkollë (4%) dhe përdorimin e pamjaftueshëm të burimeve didaktike digjitale (2%).

100% e nxënësve janë shprehur “plotësisht dakord” ose “dakord” kur pyeten mbi përkrahjen dhe trajtimin e drejtë e të barabartë të mësuesve dhe personelit ndaj tyre.

100% janë shprehur pozitivisht (“plotësisht dakord” ose “dakord”) se ndihen të sigurt në mjediset e shkollës dhe se vijnë me dëshirë në shkollë.

100% e nxënësve janë shprehur me alternativën “plotësisht dakord” për deklaratën e pyetësorit “Më pëlqen të mësoj në këtë shkollë”.

Anë e fortë:

Shumica e nxënësve mendojnë pozitivisht për personelin mësimor, cilësinë dhe sigurinë në shkollë.

Anë e dobët:

Ka disa nxënësish që shprehen me të drejtë mbi pamjaftueshmërinë e burimeve mësimore digjitale dhe kushteve fizike jo të nivelit që dëshirojnë (p.sh. ngrohjes së godinës në ditët e ftohta).

SYNIMI

Synimi ynë lidhet me dy prioritetet e përcaktuara në planin afatmesëm të shkollës: “Rritja e interesit të nxënësve për shkollën, dëshmuar me nivel më të lartë të frekuentimit të orëve mësimore dhe klubeve shkollore, si edhe uljes së numrit të nxënësve që largohen drejt shkollave të tjera” dhe “Përforcimi i imazhit të shkollës si institucion arsimor cilësor nëpërmjet arritjeve më të larta në aktivitetet konkurruese krahasuar me gjimnazet publike të ZVAP Fier dhe në rezultate më pozitive në provimet e maturës”.

Për vitin shkollor 2024-2025 synimi ynë do të vazhdojë të jetë:

Konsolidimi i imazhit pozitiv për shkollën tonë nëpërmjet rritjes cilësore në shumë drejtime, për t’u kthyer në shkollën ku nxënësit realizojnë ëndrrat dhe dëshirat.

OBJEKTIVAT

1. Në përfundim të vitit mësimor (qershor 2025) niveli i kalueshmërisë së shkollës të jetë 95% nga niveli prej 93,6% i vitit të kaluar.
Në këtë tregues nuk llogariten rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.
2. Në përfundim të sesionit të parë të Maturës Shtetërore përqindja e maturanëve kalues që arrijnë notën mesatare të kërkuar për degët prioritare (7.5) të rritet në 60% nga niveli prej 56% (74 maturanë nga 132) i një viti më parë.

VEPRIMTARITË PËR VËZHGIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT VJETOR

Për realizimin e objektivave planifikohen këto veprimtari:

Objektivi	Nr.	Veprimtaria	Ngarkohet	Afati
Në përfundim të vitit mësimor (qershor 2025) niveli i kalueshmërisë së shkollës të jetë 95% nga niveli prej 93,6% i vitit të kaluar.	1	Analizë për të përcaktuar lëndët ku ka pasur dobësi	Secili mësues i lëndëve në klasat XII	Nëntor 2024
	2	Hartimi i një plani ndërhyrjeje për ndryshimin e gjendjes në pikat e dobëta të konstatuara	Drejtoria	Janar 2025
	3	Raportim në drejtori për nivelin e arritjeve të nxënësve të rrezikuar për të mbetur në klasë	Secili mësues kujdestar i klasave XII	Mars 2025
	4	Analizë e numrit të mungesave 1-3 orëshe, si një shkak për të mbetur në klasë	Nëndrejtori	Prill 2025
	5	Takim pune me mësuesit e lëndëve ku ka problematika për kalueshmërinë	Drejtoria	Maj 2025
Në përfundim të sesionit të parë të Maturës Shtetërore përqindja e maturantëve kalues që arrijnë notën mesatare të kërkuar për degët prioritare (7.5) të rritet në 60% nga niveli prej 56% i një viti më parë.	1	Seanca orientuese me maturantët mbi përcaktimin e lëndës me zgjedhje në provimin e maturës, njohja me vështirësitë e lëndës, aftësitë e shfaqura dhe nevojat e secilit prej tyre për të arritur rezultatin e kërkuar	Mësuesit e lëndëve me zgjedhje (fizikë, kimi, biologji, ekonomi, histori, psikologji, etj.)	Nëntor 2025

Objektivi	Nr.	Veprimtaria	Ngarkohet	Afati
	2	Analizë e notave mesatare të arritura në përfundim të periudhës së parë dhe të dytë për secilin maturant		Janar 2025 Prill 2025
	3	Plan ndërhyrjeje për përmirësimin e gjendjes për maturantët me mesatare të luhatshme 7 - 8		Prill 2025
	4	Konsultime me maturantët për të gjitha lëndët e provimeve të maturës		Mars-maj 2025

VEPRIMTARITË PËR VËZHGIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT VJETOR

Për vëzhgimin e zbatimit të planit gjatë vitit shkollor 2024-2025 ngarkohet grupi i punës

Nr.	Veprimtaria vëzhguese	Afati
1	Relacion për realizimin e veprimtarive mbi objektivat e planit	Dhjetor 2025 Mars 2025 Maj 2025
2	Pjesëmarrje në seancat orientuese, konsultimet, takimet e punës	Sipas grafikut, njoftohet nga drejtoria
3	Pyetësor me maturantët me arritje mesatare mbi nivelin e asistencës që marrin nga mësuesit për eliminimin e vështirësive që kanë për arritjen e rezultateve më të larta	Prill 2025
4	Shqyrtim i rezultateve të paraprovimeve në lëndët e maturës	Maj 2025

BUXHETI

Nuk parashikohet buxhet për realizimin e objektivave të planit vjetor 2024-2025. Për këtë vit shkollor shkolla synon që të tërheqë donatorë për realizimin e projekteve cilësore.

